



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.9/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rrustem Thaqi kryesues, Afijete Sada - Glllogjani, Faton Ademi, Kymete Kicaj, Milena Đerić, Zyhdi Haziri, Burim Ademi, Ferki Xhaferi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi Pireva, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga Brikenë Berisha me adresë, Neulushein Gjermani, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen me datën 14 Shkurt 2021, në seancën e panelit të mbajtur me 25.01.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet si e palejuar ankesa Anr.9/2021 i datës 23.01.2021, i parashtruar nga Brikenë Berisha me adresë Neulushein Gjermani, me të cilin kërkon që të përfshihet në listën e votuesve jashtë Kosovës.

A r s y e t i m

Me datën 23.01.2021 PZAP-i ka pranuar një ankese nga Brikenë Berisha nga Neulushein Gjermani në të cilën theksohet se ka aplikuar duke i ndjekur rregullat e për aplikim për regjistrim të votuesve jashtë Kosove, më datë 21.01.2021 në ora 17:57, dhe se në ora 18:00 ka pranuar një njoftim me email, aplikimi ka përfunduar.

Paneli pasi që shqyrtoj lejueshmërinë e apelit gjeti se:

Apeli është e palejuar

Paneli, pasi që konstatoj lejueshmërinë e apelit, gjeti se apeli i parashtruar, është i palejuar për arsye se parashtruesi i ankesës nuk ka paraqitur ndonjë vendim të KQZ-se me të cilin ju është refuzuar aplikacioni për tu regjistruar në listën e votuesve jashtë Kosovës.

Paneli ka parasysh faktin se në rastin konkret nuk ekziston një vendim i KQZ-së me të cilin do të mund të konstatohej se parashtruesi i apelit është larguar nga lista e votuesve, andaj paneli ka parasysh se bazat e Apeleve zgjedhore ndaj vendimeve të KQZ-së, në PZAP, janë

përcaktuar me nenin 122 paragrafi 1 pikat: a) b) c) d) e) dhe f) të LZP-së, në të cilat përcaktohet se:

- **a) Përfshirjen ose largimin e një personi për të marr pjesë në programin votues brenda dhe jashtë Kosovës;**
- **b) Certifikimin ose kundërshtimin për të certifikuar një subjekt politik ose kandidat për të marrë pjesë në zgjedhje;**
- **c) Kandidati i cili pas certifikimit nuk dëshiron të marrë pjesë në zgjedhje;**
- **d) akreditimin ose refuzimin për akreditim të një vëzhguesi zgjedhor;**
- **e) vendosjen e një gjobe administrative ndaj një subjekti politik sipas nenit 42 të këtij ligji dhe**
- **f) Refuzimin për të regjistruar një parti politike brenda Zyrës.**

Andaj mbi këtë bazë Paneli vlerëson se apeli është e palejuar. Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me nenin 118 të LZP-së dhe nenin 11 paragrafi 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
A nr. 9/2021 më datën 25.01.2021



Kryesuesi i Panelit

Rrustem Thaqi

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në *Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.*